



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 16 datë 25.3.2021**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.6 DT. 30.01.2018  
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË  
ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË  
PUNONJËSVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SHKODËR DHE  
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË” TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 25.3.2021, zhvilluar online, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetje të ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 54 germa “ç” ; ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë” ; Ligjit nr.10405, date 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; VKM nr. 1149 datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 175 dt. 08.03.2017 të KM “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”; VKB nr.6 dt. 30.01.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” të ndryshuar; VKB nr. 63 , datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër“ ; shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2987, datë 11.02.2021 me objekt “Dërgohet fondi i rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor”, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një ndryshim në VKB nr.6 dt. 30.01.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, sa i takon ndryshimit të nivelit të pagave të punonjësve mësimorë të arsimit parashkollor në Bashkinë Shkodër, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Efektet financiare fillojnë me date 01.01.2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Briseta KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lësha**

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 26.3.2021

Ishte

**Struktura e pagës të punonjësve mësimorë të arsimit parashkollor dhe drejtuesit në institucionet parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve**

**Tab.3**

Emërtimi	Arsimi i lartë		Vjetersia
	Kategoria	Pozicioni	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	51000	2%
Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	44000	2%
Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	42500	2%
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	45000	2%
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	42500	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	1	36650	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	2	34000	2%



Bëhet

**Struktura e pagës të punonjësve mësimorë të arsimit parashkollor dhe drejtuesit në institucionet parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve**

Tab.3

Emërtimi	Arsimi i lartë		Vjetërsia
	Kategoria	Pozicioni	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	58650	2%
Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	50600	2%
Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	48900	2%
Drejtor i kopshtit me ushqim	1	51750	2%
Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	48900	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	1	42200	2%
Edukator në kopsht fëmijësh	2	39100	2%

